



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr._____/2019

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438,
DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas fjalisë së parë, të pikës 4, të nenit 13, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Ky përjashtim nuk zbatohet për individët të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënëse. Këta individë deklarojnë në deklaraten e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruar nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit.”.

Neni 2

Në paragrafin e dytë, të nenit 20, fjalët “... fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore ...” zëvendësohen me “... fatura, e cila është lëshuar në përputhje me ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”...”.

Neni 3

Fjala e dytë, e shkronjës “j”, të pikës 1, të nenit 21, ndryshohet, si më poshtë vijon :

“Nuk njihen si shpenzime të zbritshme, për qëllime tatimore, shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, të ndryshuar.

Për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumat e sponsorizuara, brenda kufijve të parashikuar në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, të ndryshuar, për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, për efekt të përlogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar. Nuk lejohet mbartja e tyre në periudhat tatimore të ardhshme. Parashikimet e këtij paragrafi aplikohen pas lëshimit të “Autorizimit të sponsorizimit” nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 4

Pas pikës 1, të nenit 27, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Për tatimpaguesit, të cilët investojnë në projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliard lekë, në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në pesë periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit “humbja e parë më përpara se ajo e fundit”. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike.”.

Neni 5

Pas pikës 4, të nenit 28, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Për personat juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotive, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim aktivitetet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2020, me përjashtim të nenit 2, të këtij ligji, i cili hyn

në fuqi dhe zbatohet sipas afateve të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI